



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**L I G J (projekt)**

**Nr.2020**

**PËR**

**BUXHETIN E VITIT 2021**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**BUXHETI**

**Neni 1**

Buxheti për vitin 2021 është:

Të ardhurat	478 965	milionë lekë;
Shpenzimet	587 660	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve.

**Neni 2**

Buxheti i shtetit për vitin 2021 është		
Të ardhurat	352 984	milionë lekë;
Shpenzimet	461 679	milionë lekë;
Deficiti	108 695	milionë lekë.

### Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2021 është:

Të ardhurat	56 326	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	18 200	milionë lekë;
- transferta e pakushtëzuar sektoriale	7 850	milionë lekë;
-transferta specifike per emergjencat civile	500	milione leke
- Të ardhura të tjera	29 776	milionë lekë;
Shpenzimet	56 326	milionë lekë.

### Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është:

1. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat, gjithsej	137 133	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	83 675	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	51 238	milionë lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	2 220	milionë lekë;
Shpenzimet	137 133	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2021, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat, gjithsej	7 532	milionë lekë;
Nga të cilat:		

- kontributet	1 796	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 556	milione lekë;
- Transferta për indeksimin e pensioneve	180	milione lekë;
Shpenzimet	7 532	milione lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2 400 milione lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 500 milione lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Nga teprica e të ardhurave dhe fondi rezerve i sigurimeve shoqërore përdoren 4 000 milione lekë financimin e shpenzimeve si më sipër.

#### Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej,	46 306	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet dhe të tjera	14 084	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	32 222	milione lekë;
Shpenzimet	46 306	milione lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 10500 milione lekësh, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga fondi rezerve i sigurimeve të kujdesit shëndetësor përdoren 2 000 milione lekë për financimin e shpenzimeve si më sipër.

#### Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2021 është:

Të ardhurat, gjithsej,	3 000	milione lekë;
Nga të cilat:		
- të ardhura të tjera	1 000	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	2 000	milione lekë;
Shpenzimet	3 000	milione lekë.

## Neni 7

Fondi i Rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, prej 28 000 milionë lekë, përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe për projekte të reja.

Ky fond, shton kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion në nivel programi dhe kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, të miratuar në tabelën 1 dhe 3 të nenit 11 dhe 15 të këtij ligji.

Çdo e ardhur në formë granti me destinacion përballimin e pasojave të tërmetit, rrit në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet e Fondit të Rindërtimit, duke shtuar kufijtë e përcaktuar në nenin 1, 2, 3 dhe 11, si dhe kufijtë e miratuar në tabelat 1, 3 dhe 4 të nenit 11 dhe 15 të këtij ligji.

Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe përdoren për të njëjtin qëllim.

## Neni 8

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## KREU II

### BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

## Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	20 353	milione lekë;
Të ardhurat tatimore	311 031	milione lekë;
Të ardhurat jotatimore	21 600	milione lekë.

## Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër se sa deficiti i përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të brendshme deri në kufirin maksimal prej 49 900 milionë lekë.

Pjesa tjetër e financimit të deficitit faktik të buxhetit të shtetit, financohet nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, si dhe ndryshimit pakësues ose shtues të gjendjes së llogarisë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë dhe llogarive të fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja është rreth 13 552 milion lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative si më poshtë:

- Huamarrje afatgjatë të destinuara për projekte me vlerë rreth 24 678 milion lekë
- Huamarrje në formën “mbështetje buxhetore” nga institucione financiare ndërkombëtare me vlerë rreth 29 764 milion lekë
- Ripagesa të principalit me vlerë rreth - 40 890 milion lekë

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë është rreth 39 242 milion lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milion lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë, ose në rast mungese përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenin 1 dhe 2 të këtij ligji.

### KREU III

#### SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

##### Neni 11

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	453 179	milionë lekë;
- Fondi rezervë i buxhetit	2 000	milionë lekë;
- Fondi për zgjedhjet parlamentare	1 000	milionë lekë
- Fondi për studime dhe projekte	1 000	milionë lekë
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 500	milionë lekë;

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për

shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 janë kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2022 dhe 2023. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2021.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4.

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mund të fillojnë procedurën e prokurimit që në muajin nëntor të vitit korrent, nëse fondet janë akorduar/regjistruar në sistemin e thesarit për vitet 2021 dhe 2022, me kushtin që lidhja e kontratës të bëhet efektive vetëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 12

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 83 702 veta. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministrinë dhe institucionet qendrore, në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja.

Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve të reja. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror.

Për vitin 2021 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlllogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja.

Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura, në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përlllogaritur sipas gradave të miratuara.

Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 250 milionë lekë shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të Ministrisë përgjegjëse për Financat. Shumat e shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në tabelën 1, që përmendet në nenin 11, të këtij ligji.

## Neni 13

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## Neni 14

Fondi rezervë prej 4 000 milionë lekë përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për:

- raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme në masën 2 000 milionë lekë;
- përballimin e kostos së zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021 në masën 1 000 milionë lekë;
- për hartimin e studimeve të projekteve të investimeve publike strategjike në masën 1 000 milionë lekë.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4500 milionë lekë përdoret nga Ministri përgjegjës për Financat për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë dhe kontingjenca për risqet e borxhit, shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 11 të këtij ligji.

## Neni 15

Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shpërndahet ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme përdoret nga Ministria përgjegjëse për Financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve dhe programi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale përdoren sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transfera specifike për funksionet e reja të transferuara në bashkitë shpërndahet sipas anekseve 1, dhe 4, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta.

Fondet e trashëguara nga vitet e mëparshme përdoren nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri përgjegjës për financat.

## Neni 16

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive:

- a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- b) granti i mësimdhënies;
- c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenin 111 dhe nenin 113, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Fondi i projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë, mund të shpërndahet edhe tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, në ato raste kur me vendim të Këshillit të Ministrave, ato përcaktohen Autoritete Kontraktore për realizimin e procedurave të prokurimit për studim projektimin apo zbatimin e projektit për një ose disa institucione të arsimit të lartë. Në këto raste, çelja e fondit nga Ministria përgjegjëse për financat bëhet pas paraqitjes së kërkesës nga Njësia e vetëqeverisjes vendore, përmes Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Detajimi i fondeve realizohet në përputhje me detyrën e projektimit apo projektin e zbatimit të paraqitur nga NJQV-ja, e shoqëruar edhe me vendimin e organeve kolegjiale të NJQV-se dhe/ose me vendimin e organeve kolegjiale të IAL-se, në rastin kur ato marrin përsipër bashkëfinancimin e projektit. Fondet e akorduara për NJQV sa me sipër, trashëgohen në vitin pasardhës.

## Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Të drejtat e përcaktuara në nenin 44, të ligjit nr. 9636 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për rishpërndarjen e fondeve buxhetore, përcaktojnë treguesit e faktit në tabelat nr. 1 dhe 4, të cituara në këtë ligj.



## Neni 18

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2020, në përputhje me të dhënat e regjistrimit të koncesioneve është 49.8 % e PBB-së. Çdo kontratë e re ndjek procedurat dhe rregullat e legjislacionit në fuqi për koncesionet/PPP-të.

## Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2021, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 49 952 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj deri në 63 452 milionë lekë.
- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në (minus) -13 500 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 332 453 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 226 026 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të garantur nga qeverisja qendrore 55 628 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 800 milionë lekë.

## Neni 20

Në rast të disbursimit të ndonjë kredie shtesë në formën “mbështetje buxhetore” nga institucionet financiare ndërkombëtare, vlerat indikative respektive të përcaktuara në nenin 10 dhe 19 të këtij ligji, mund të rriten automatikisht. Ndërkohë niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2021 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1.

Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë unike të Këshillit të Ministrave në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet dhe mbartet për të financuar buxhetet e viteve fiskale pasardhëse, por

në mbyllje të vitit buxhetor gjendja e akumuluar nuk duhet të kalojë vlerën mesatare prej dy muajsh kumulativë të shpenzimeve buxhetore.

#### Neni 21

Ngarkohet Ministri përgjegjës për Financat të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

#### Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**